

INFORMACION

NË

LIDHJE ME PROJEKTIN “MBËSHTETJA E AVOKATIT TË POPULLIT TË SHQIPËRISË – MË PRANË KOMUNITETEVE LOKALE, SHOQËRISË CIVILE DHE MEDIAS (2012-2015)”

Institucioni i Avokatit të Popullit po zbaton që prej vitit 2012, Projektin “Mbështetja e Avokatit të Popullit të Shqipërisë – më pranë komuniteteve lokale, shoqërisë civile dhe medias (2012-2015)”. Ky është një projekt katër vjeçar në mbështetje të të drejtave të njeriut dhe mirëqeverisjes në Shqipëri.

Ky projekt financohet nga Ministria e Punëve të Jashtme të Qeverisë së Mbretërisë së Danimarkës me vlerë 10 milionë korona daneze, i bazuar në **Marrëveshjen nr. 175, datë 21.12.2011, “Projekt marrëveshje midis institucionit të Avokatit të Popullit të Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Danimarkës të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Danimarkës, për (Mbështetja e Ombudsmanit Shqiptar- Shtrirja te komunitetet lokale, shoqëria civile dhe media”**. Ky fond ndahet:

- Asistenca teknike ndërkombëtare që menaxhohet nga vetë donatori (5 milionë korona);
- Financimi i drejtpërdrejtë për institucionin e Avokatit të Popullit (4 milionë korona);
- Marzhi i buxhetit (të paalokuara), për t'u vendosur nga Komiteti Drejtues (1 milionë korona).

Financimi i drejtpërdrejtë me vlerë prej 4 milion DKK, konsiston në aktivitetet që mbulohen nga planet e punës dhe buxhetet e aprovuara nga Komiteti Drejtues i Projektit.

Projekti zbatohet nga Instituti Danez për të Drejtat e Njeriut në bashkëpunim me SIPU International AB (Instituti Suedez për Administratën Publike). Ai synon ta bëjë institucionin e Avokatit të Popullit më efektiv në tre fusha strategjike që pasqyrojnë ngritjen organizative të institucionit e që në të njëjtën kohë përputhen me Opinionin e Komisionit Evropian në prioritetet kyçe për reformën e qeverisjes shqiptare. Ky projekt ka për qëllim të ndërtojë kapacitetet institucionale mbi mbulimin e nivelit lokal si dhe lidhjet e forta me shoqërinë civile dhe median nëpërmjet kombinimit të financimit direkt të institucionit të Avokatit të Popullit dhe asistencës teknike ndërkombëtare.

Objektivat e zhvillimit

Objekivi i përgjithshëm i këtij projekti mbështetjeje për institucionin Avokatin e Popullit të Shqipërisë është të kontribuojë për vazhdimësinë e procesit të reformave kombëtare dhe përpjekjeve për demokratizim, në përputhje me parimet bazë të Kushtetutës së Shqipërisë për një Shqipëri të lirë, të drejtë dhe të begatë me:

- Garancitë demokratike efektive në nivel qendror dhe lokal të qeverisjes;
- Mundësi të aksesueshme nga qytetarët për zbatimin e të drejtave themelore të njeriut;
- Perspektiva të përmirësuara për Shqipërinë që të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian.

Objektivat imediatë

Objektivi imediat është forcimi i kapaciteteve të institucionit të Avokatit të Popullit me qëllim që të mundësohet institucioni të ecë përpara në mënyrë efektive me mandatin e tij për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individëve nga veprimet e paligjshme apo të parregullta apo mosveprimet e organeve të administratës publike.

Më konkretisht, projekti ka për qëllim të ndërtojë kapacitetet institucionale dhe të forcojë lidhjet me shoqërinë civile dhe median, për ta bërë Avokatin e Popullit më efektiv në këto tre komponentë me rëndësi të veçantë për institucionin:

1. Forcimi i garancive demokratike në nivel lokal për qytetarët dhe shoqërinë civile
2. Përmirësimi i kushteve në burgje dhe në qendrat e paraburgimit
3. Rritja e profilit publik dhe e pozicionit të Avokatit të Popullit nëpërmjet lidhjeve me shoqërinë civile dhe median.

Përveç tre komponentëve kryesore projekti ka mbështetur edhe 2(dy) nën komponentë të tjerë siç janë:

- hartimi i një strategjie për zhvillimin e institucionit për periudhën 2012-2015,
- komponent i IT-së.

Projekti ka konsistuar në asistencën teknike për zhvillimin e strategjisë, -ndërtimin e kapaciteteve dhe trajnimin e stafit si dhe aktivitetet me aktorë në nivel lokal, -për rritjen e profilit të institucionit të Avokatit të Popullit nëpërmjet formave të ndryshme të ndërveprimit me organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e qytetarëve.

Pushteti vendor është një partner thelbësor i institucionit të Avokatit të Popullit në kuadër të këtij projekti. Aktivitetet e komponentit të pushtetit vendor zhvillojnë eksperiencën në organizimin e Ditëve të Hapura dhe mbështesin aspiratat e Avokatit të Popullit për forcimin e rolit të tij në shqyrtimin e ankesave dhe përkrahjen e të drejtave të njeriut, transparencën në procesin e vendim-marrjes dhe parandalimin e korrupsionit në nivel bashkie dhe komune.

Këto aktivitete synojnë promovimin e përgjegjshmërisë së administratës publike shqiptare në nivel lokal. Pjesë e aktiviteteve të këtij komponenti në bashkëpunim me organizatat më të spikatura të shoqërisë civile është trajnimi i nëpunësve të pushtetit vendor me fokus rritjen e ndërgjegjësimit për çështjet e të drejtave të njeriut. Në kuadër të këtij komponenti janë hapur dhe kompletuar me pajisjet e nevojshme shtatë zyra rajonale të Avokatit të Popullit në qarqe të ndryshme të vendit.

Përmirësimi i kushteve në burgje dhe në qendrat e paraburgimit është një komponent tjetër i këtij projekti. Mbështetur në këtë projekt është mundësuar kryerja shumë inspektiveve, ri-inspektiveve, kontrolleve me tematikë të veçantë dhe vizita monitoruese në të gjitha institucionet ku privohet liria e individit me pjesëmarrje të rregullt të organizatave të shoqërisë civile. (institucione penitenciare, njësi policore,

spitale psikiatrike, baza ushtarake ku ka dhoma sigurie, qendra ku trajtohen shtetas të huaj, azilkërkues dhe viktimat e trafikut).

Bashkëpunimi i ngushtë me organizatat e shoqërisë civile ka qenë një aspekt tjetër i punës së projektit. Si në komponentin e burgjeve dhe qendrave të burgimit ashtu edhe në komponentin e shoqërisë civile është arritur që të realizohen inspektime të përbashkëta të institucionit të Avokatit të Popullit me organizata të shoqërisë civile, inspektime që kanë pasur një karakter multidisiplinar dhe të thelluar. Si rrjedhojë e bashkëpunimit efektiv midis institucionit të Avokatit të Popullit dhe organizatave të shoqërisë civile janë prodhuar një sërë materialesh promovuese si studime të ndryshme, fletëpalosje, postera shpjeguese, etj.

Është krijuar një rrjet profesional i medias, për të forcuar pozicionin e institucionit të Avokatit të Popullit nëpërmjet lidhjeve aktive të komunikimit me median profesionale. Ky rrjet gazetarësh mbledhet rregullisht për të diskutuar mbi mekanizmat e dialogut për mbulimin e çështjeve të drejtave të njeriut në median e shkruar dhe atë vizive. Rrjeti i medias ka zhvilluar disa udhëtime studimore jashtë vendit për tu njohur me praktikat më të mira ndërkombëtare në këtë fushë.

Vendimmarrja e projektit realizohet nëpërmjet mbledhjeve të Komitetit Drejtues, në përbërje të të cilit janë: Avokati i Popullit, Ministria e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Danimarkës, Ambasada e Mbretërisë së Danimarkës në Tiranë, Zyra e Prezencës së OSBE-së, Zyra e Këshillit të Evropës, Zyra e Delegacioni i BE-së, Zyra e Kombeve të Bashkuara/UNDP, etj. Institucionet Ndërkombëtare janë ftuar në Komitetin Drejtues të Projektit për një qëllim të dyfishtë, atë të sigurimit të cilësisë teknike dhe për koordinimin e donacionit. Megjithatë, pronësia dhe gjithë përgjegjësia për zbatimin ditë pas dite, qëndron vetëm tek institucioni i Avokatit të Popullit.

Bazuar në marrëveshjen midis Ministrisë së Punëve të Jashtme të Danimarkës dhe Avokatit të Popullit të Shqipërisë, financimi i drejtpërdrejtë bëhet për aktivitete që mbulohen nga planet e punës dhe buxhetet e aprovuara nga Komitetit Drejtues i Projektit. Financimi është i kanalizuar në llogari bankare të ndryshme, të përdorshme në përputhje me planet e punës dhe buxhetet e aprovuara nga Komitetit Drejtues i Projektit dhe është subjekt i kontrollit ndërkombëtar të llogarive. Financimi direkt është modaliteti kryesor i zgjedhur për të promovuar pronësinë kombëtare të projektit.

INSTITUCIONI QENDROR: Avokati i Popullit

EMËRTIMI I PROJEKTIT: Projekti Danez

KREDITORI : Ministria e Punëve të Jashtme të Qeverisë së Mbretërisë së Danimarkës

Nr. i Llogarisë Speciale në Bankën e Shqipërisë: 2117-513L, IBAN: AL11 1011 1008 0000 0000 2117 513L

Nr. i Llogarisë në Bankën e nivelit II-të: 401638131, IBAN: AL56 2051 1014 6381 31CL TJCL ALLA

Lloji i financimit: Grant

Pasqyra financiare të planifikimit dhe zbatimit të Projektit Danez

Nr.	Emërtimi	Plani i Përgjithshëm DKK	Viti 2013			Viti 2014			Viti 2015		
			Plani DKK	Fakti në lekë	Fakti në DKK	Plani DKK	Fakti në lekë	Fakti nëDKK	Plani DKK	Fakti në lekë	Fakti në DKK
	Financimi Direkt	4,000,000									
1	Strategjia		450,000	1,775,119	94,526.45	0	0	0.00	0	0	
2	Komponenti i Pushtetit Vendor		929,289	0	0.00	1,032,600	3,364,408	179,532.52	784,119		
3	Komponenti i Burgjeve MKPT		178,211	67,500	3,601.92	243,450	963,340	51,648.84	553,954		
4	Komponenti i Shoqërisë Civile dhe Media		356,894	2,605,501	138,910.20	499,560	1,458,983	77,329.20	666,200		
5	Komponenti i IT		375,957	572,400	30,430.62	500,000	7,626,290	404,594.48	110,000		
6	Rekrutimi		0	0	0.00	138,040	2,211,862	117,892.93	172,550		
7	Përkthime të institucionit		50,000	525,590	28,061.40	26,480	492,700	26,221.39	125,000		
8	Auditimi		0	0	0.00	64,000	1,184,409	62,967.34	64,000		
9	Kontigjenca		0	0	0.00	40,000	0	0.00	40,000		
10	Vizita studimore		0	0	0.00	0	0	0.00	169,560		
11	Rekrutimi i Arkivisti		0	0	0.00	0	0	0.00	13,400		
12	Kosto ekspetesh ndërkombëtar								19,000		
Totali			2,340,351	5,546,110	295,530.59	2,544,130	17,301,992	920,186.70	2,717,783	0	0